

LETËR POZICIONIMI

Krimi Mjedisor dhe Policimi në Komunitet

"Për çfarë na duhet një shtëpi e bukur nëse nuk kemi një planet të pranueshëm për ta vendosur?"

Henry David Thoreau



Autorët: Ermal Nazifi, Petrina Broka, Elvis Çela, Amantia Lleshi
Grafika: Besmir Hoxha

Shkurt 2015

© Qendra Mjedisore për Mbrojtje Edukim dhe Rehabilitim (Qendra EPER).

TABELA E PËRMBAJTJES

I. Hyrje

II. Kuadri ligjor dhe institucional

III. Praktika e zbatimit të legjislacionit penal mjedisor

IV. Policimi në komunitet si mjet efektiv për luftën ndaj krimin mjedisor.

V. Niveli i policimit në komunitet për krimin mjedisor

VI. Konkluzione dhe Rekomandime

I. Hyrje

Mbrojtja e elementeve bazë të mjedisit është një domosdoshmëri për jetën e shëndetin e çdo njeriu. Cilësia e ajrit, cilësia e ujit, niveli i pastërtisë nga mbetjet, niveli i zhurmave dhe mbrojtja e bio-diversitetit janë elementet më thelbësore për një jetë të shëndetshme.

Në këtë mënyrë, mbrojtja e mjedisit është një nga detyrat kryesore të të gjithë shoqërisë, çdo qytetari dhe pa dyshim qeverisë dhe institucioneve. Shqipëria ka një kuadër ligjor në përputhje me standardet ndërkombëtare e mbështetja e komunitetit ndërkombëtar në këtë fushë nuk ka munguar. Megjithatë situata e mjedisit në Shqipëri ka bërë pak progres sipas Raport Progresit 2014 të Komisionit Europian për Shqipërinë¹.

Një nga format e mbrojtjes së mjedisit është edhe parashikimi i dënimeve penale për një sërë sjelljesh që dëmtojnë rëndë mjedisin që na rrethon. Legjislacioni penal mjedisor në Shqipëri prej kohësh ka parashikuar një sërë veprash penale si ndotja e ajrit, ndotja e ujit, prerja e pyjeve, peshkimi i paligjshëm, prishja e qetësisë publike etj. Megjithatë numri i të dënuarve për këto vepra penale mbetet tepër i ulët krahasuar me perceptimin publik për përhapjen e këtyre veprave.

Një ndër problemet kryesore është edhe mungesa e denoncimeve për raste konkrete nga qytetarët si dhe sigurimi i provave të domosdoshme për kapjen e dënimit e autorëve.

Zgjidhja e mundshme e këtij problemi do të ishte një bashkëpunim sa më i madh i komuniteteve të prekura nga krimi mjedisor me policinë e shtetit në kuadër të policimit në komunitet. Një bashkëpunim i tillë ndërmjet qytetarëve dhe policisë do të siguronte që të rritej numri i procedimeve e dënimeve penale për autorët e krimeve mjedisore.

Në këtë letër pozicionimi do të diskutohet rëndësia e policimit në komunitet për të luftuar krimin mjedisor, gjendja aktuale, problemet dhe disa rekomandime për përmirësimin e gjendjes.

Letra e pozicionimit “Krimi mjedisor dhe policimi në komunitet” është fokusuar kryesisht në rajonin e Tiranës. Kjo letër është bazuar në: i) studime të mëparshme të kryera nga organizma kombëtarë e ndërkombëtarë; ii) legjislacionit kuadër të mjedisit dhe kodin penal iii) kërkime të ndryshme në internet e literaturë; iv) Statistikat e Ndryshme të Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë, v) takime me komunitetin; vi) intervista të

¹Shih faqe 56 të Raportit Progresit 2014 të Komisionit Europian për Shqipërinë
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf

drejtpërdrejta me prindër e anëtarë të komunitetit të Tiranës. Vii) analizën e pyetësorit të përgatitur për këtë qëllim.

Kjo letër pozicionimi është përgatitur nga Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim (Qendra EPER) në kuadër të projektit “Larg krimit mjedisor me besimin tek Policia e Shtetit”. Ky projekt mbështet financiarisht nga Qeveria Suedeze, në kuadër të programit “Policimi në Komunitet”.

II. Kuadri ligjor dhe institucional

Mbrojtja e mjedisit është një parakusht për gëzimin e të drejtave të njohura të individit. Kështu mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit janë një pjesë integrale e gëzimit të së drejtës për shëndet, për ushqim dhe jetë, duke siguruar një cilësi të mirë jetese për të gjithë.

Dëmtimi i mjedisit sjell pasoja të rënda për shëndetin, klimën, florën e faunën duke cenuar deri edhe ekzistencën e njeriut në Tokë. Edukimi e ndërgjegjësimi i qeverive, i qytetarëve për rëndësinë e mjedisit është padyshim mjeti më i rëndësishëm për mbrojtjen e tij. Por nga ana tjetër është i nevojshëm një kuadër ligjor i plotë e funksional për mbrojtjen e mjedisit.

Kushtetuta e Shqipërisë në Nenin 59, pika “d” dhe “dh” njeh si një objektiv social të drejtën për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, si dhe shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ligji bazë për mjedisin në Shqipëri është Ligji Nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”. Sipas këtij ligji mjedisi përkufizohet si “përbërësit natyrorë ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve të këtyre elementeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu”².

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Objektivi kryesor i ligjit për mbrojtjen e mjedisit është parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji.

Ligji ka parashikuar se mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji ndër të tjera ka parashikuar ngritjen e strukturave përkatëse administrative për zbatimin e legjisllacionit mjedisor si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Ky i fundit mund të vendosë edhe gjoba për shkelje të ndryshme të ligjit.

² Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” Dt.Aktit:09.06.2011, Dt.Miratimit:09.06.2011, Flet.Zyrtare Nr.89, Faqe:3680.

Gjithashtu ligji garanton të drejtën e publikut për tu informuar e për të marrë pjesë në vendim-marrje për çështje që kanë lidhje me mjedisin. Është parashikuar edhe e drejta e qytetarëve për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit. Megjithatë ligji nuk ka përcaktuar se çfarë mund të kërkohet ekzaktësisht nga qytetarët si psh ndalimi i shkeljes, dëmshpërblimi etj.

Ligji nuk përcakton nëse çdo qytetar mund të ngrejë padi për çfarëdo lloj dëmi apo duhet të kenë ardhur pasoja të drejtpërdrejta për të, në mënyrë që të legjitimohet ngritja e padisë. Ligji nuk ka parashikuar as të ashtuquajturat padi përfaqësuese ku organizata apo grupime të ndryshme kanë të drejtë të ngrenë padi në emër të qytetarëve për shkeljet e legjislacionit mjedisor.

Përveç ligjit “për mbrojtjen e mjedisit”, janë miratuar një sërë ligjesh të veçanta për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, për menaxhimin e integruar të mbetjeve, për biodiversitetin, për pyjet, për ndalimin e gjuetisë, etj.

Me gjithë parashikimin e një sërë ligjesh për mbrojtjen e mjedisit nga institucionet administrative është parë e nevojshme që edhe legjislacioni penal të ketë rolin e vet në parandalimin e shkeljeve mjedisore si dhe në dënimin e personave që kryejnë vepra penale mjedisore.

Është pikërisht Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë që ka parashikuar një sërë veprash penale në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Neni 1/b i Kodit Penal, “Detyrat e legjislacionit penal shqiptar”, përmend mjedisin në mënyrë të veçantë si një ndër të mirat juridike të rëndësishme, të cilën legjislacioni penal ka për detyrë ta mbrojë nga veprat penale. Mbrojtja penale është mbrojtja e fundit e mjedisit vetëm në rast se të gjitha masat e tjera parandaluese dhe rregullatore kanë dështuar.

Që nga miratimi i kodit penal në vitin 1995 ka pasur një rritje e numrit të veprave penale dhe/ose një specifikim më të detajuar të tyre. Shumica e veprave penale ndaj mjedisit janë kundërvajtje penale por ka edhe një sërë krimesh të parashikuara në kod. Një karakteristikë shumë e rëndësishme është se nuk kërkohet ardhja e pasojave të rënda për klasifikimin si vepër penale.

Kreu IV i pjesës së posaçme, parashikon veprat penale konkrete ndaj mjedisit të cilat paraqiten në formë tabelare më poshtë.

Tabela 1: Llojet e veprave penale kundër mjedisit	
Ndotja e ajrit	Neni 201
Transportimi i mbeturinave toksike	Neni 202
Ndotja e ujërave	Neni 203

Peshkimi i ndaluar	Neni 204
Prerja e paligjshme e pyjeve	Neni 205
Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor	Neni 206/a
Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor	Neni 206/b
Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë	Neni 206
Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	Neni 207

Policia e Shtetit është përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë hetimore në përputhje me legjislacionin përkatës të procedurës penale ndërkohë që Prokuroria është organi përgjegjës për ndjekjen penale të këtyre veprave.

III. Praktika e zbatimit të legjislacionit penal mjedisor

Një nga sfidat e Shqipërisë gjatë tranzicionit janë ligjete mira përballë zbatimit të tyre vakët në praktikë. Kësaj sfide nuk i ka shpëtuar as legjislacioni penal në fushën e mjedisit.

Kështu numri i të dënuarve për vepra penale mjedisore mbetet përgjithësisht i ulët me përjashtim të veprave penale të prerjes së pyjeve të cilat kanë një numër të konsiderueshëm të dënuarish. Gjithsesi këto shifra mbeten të ulëta duke pasur parasysh raportimet e mediave për vepra të tilla.

Lloji i veprës	Neni	Numri i të dënuarve
Ndotja e ajrit	Neni 201	29
Transportimi i mbeturinave toksike	Neni 202	0
Ndotja e ujërave	Neni 203	0
Peshkimi i ndaluar	Neni 204	101
Prerja e paligjshme e pyjeve	Neni 205	1192
Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor	Neni 206/a	0
Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor	Neni 206/b	1342
Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë	Neni 206	16
Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	Neni 207	0

Edhe vetë kuadri ligjor, është një nga shkaktarët e këtij problemi. Aktualisht mungojnë disa vepra penale të cilat kanë qenë të parashikuara më parë si gjuetia e paligjshme apo trajtimi i pakujdesshëm i gjësë së gjallë. Gjithashtu legjislacionit tonë i mungojnë figura të veçanta për ndotjen e tokës, tregtia e paligjshme e kafshëve të egra, tregtia e paligjshme e substancave që ndikojnë në hollimin e shtresës së ozonit, transportimi apo hedhja e paligjshme e mbeturinave etj³.

Një problem tjetër i madh mbetet mungesa e një ndarje të qartë të shkeljeve administrative nga ato penale, ku shumë vepra penale të proceduara janë konsideruar nga Prokuroria dhe Gjykatat kompetentekundërvajtje administrative⁴.

Por pa dyshim problemi më i madh mbetet mungesa e bashkëpunimit të policisë me komunitetet e prekura duke pasur një numër të ulët të denoncimeve. Gjithashtu ka edhe vështirësi të mëdha në mbledhjen e provave për të çuar para drejtësisë një numër më të madh ndotësish.

³Shih psh. Direktiva 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit me anë të ligjit penal.

⁴ Shih psh. <http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/krimi-mjedisor-na-o-t-forcohen-penalitetet-p-r-abuzuesit-205595.html#sthash.eL9VS1c5.dpuf>

IV. Policimi në komunitet si mjet efektiv për luftën ndaj krimit mjedisor

Policimi në komunitet synon në zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe komunitetit, për të mundësuar analizë të përbashkët të problemeve, për të përcaktuar rrënjët e shkaqeve të këtyre problemeve, dhe për të identifikuar zgjidhjet e mundshme, duke u bazuar në nocionin e ndarjes së përgjegjësisë për të mbajtur komunitetin të sigurt. Qëllimi kryesor është që të ketë një angazhim të përbashkët për të parandaluar incidentet, para se të luftohet ndaj tyre.

Policia në mënyrë që të rritet efektiviteti i saj në parandalimin apo ndalimin e kryerjes së veprave penale (sidomos për ato ndaj mjedisit) nuk duhet të angazhohet vetëm kur ka lindur problemi, por të mundohet që me anë të komunikimit dhe takimeve të shpeshta me komunitetin të parandaloj problemet mjedisore apo të minimizoj këto probleme.

Policia nuk duhet të konceptohet vetëm si ndëshkuese e keqbërësit dhe që i zgjidh problemet që lindin në komunitet vetëm nëpërmjet zbatimit të ligjit. Është e domosdoshme që të kryhet një vlerësim i gjithanshëm i çështjeve dhe problemeve në aspektin social.

Qëllimi i policimit në komunitet është që të parandalojë veprat penale e të ndalojë autorët e veprave penale duke pasur një afrim, edukim, ndërgjegjësim, e bashkëpunim ndërmjet policisë dhe komunitetit. Për këtë është e nevojshme që të ndryshojë jo vetëm mendësia e komunitetit por edhe ajo e policisë.

Në mënyrë që të nxitet bashkëpunimi i komunitet me policinë është e nevojshme që të ndërmerren hapa konkrete për hartimin e strategjive mbi policimin në komunitet duke përfshirë edhe çështjet e mjedisit.

Strategjia duhet të sigurojë masa konkrete për përfshirjen dhe bashkëveprimin e komunitetit si pjesëmarrës, kontribues dhe përfitues i policimit në komunitet. Në këtë kuadër duhet që të caktohen struktura përgjegjëse pranë komisariateve që do të merret me hartimin e strategjive për policimin në komunitet, trajnimin e oficerëve të policisë, si dhe monitorimin e kësaj veprimtarie. Për këtë arsye është e domosdoshme që të maten perceptimet e publikut mbi performancën e policisë duke i kushtuar rëndësinë e duhur edhe krimit mjedisor.

V. Niveli i policimit në komunitet për krimin mjedisor

Me qëllim që të matet perceptimi i komunitetit në lidhje me krimin mjedisor dhe qasjen ndaj tij nga policia e shtetit dhe vetë komuniteti është përgatitur një pyetësor nga ana e Qendrës EPER. Pyetësorët dhe të gjitha të dhënat e mbledhura janë përpunuar nga ana statistikore dhe sociale posaçërisht për t' u publikuar në këtë letër pozicionimi.

Nga intervistimi i kryer me anëtarë të komunitetit të Tiranës u vunë re disa sfida kryesore në aspektin e ndërgjegjësimit dhe adresimit të problematikave mjedisore. Për të sjellë një panoramë sa më të plotë dhe të përditësuar, në analizën e situatës aktuale të problematikave mjedisore dhe bashkëpunimit me policinë në lidhje me to, përveç studimeve të mëparshme, kërkimeve në internet, opinioneve nga takimet e drejtpërdrejta me punonjës të policisë janë marrë në konsideratë gjithashtu edhe përgjigjet e dhëna gjatë intervistave sipas pyetësorëve përkatës të shpërndarë në tri zona tëndryshme të qytetit të Tiranës.

Gjithsej janë intervistuar 90 anëtarë të komunitetit të grupmohës 18-55 vjeç. Gjithashtu u zhvilluan 3 takime komunitare me rreth 150 prindër të nxënësve tëgjimnazeve “Besnik Sykja”, “Ismail Qemali” dhe “Ibrahim Rugova” në Tiranë. Nëpërmjet këtyre intervistave u synua të evidentohet problematikat mjedisore me të cilat përballet komuniteti dhe si i adreson ato.


Nga anketimi kanë rezultuar dhe janë përpunuar këto të dhëna:

Në Tiranë janë intervistuar 90 anëtarë të komuniteti 51 meshkuj dhe 39 femra (shih Tab.3, grafiku 1).

Tabela 3 – Ndarja gjinore e të intervistuarve

Gjinia e të intervistuarve		
Meshkuj	51	56,7%
Femra	39	43,3%

Grafiku 1 - Ndarja gjinore e të intervistuarve



Ndër problematikat mjedisore kryesore konstatohen: mungesa e koshave të mbeturinave, hedhja e mbeturinave nga dritaret e shtëpive, në ambiente publike apo djegia e tyre në koshë; zhurmat apo ndotja akustike; mungesa e kapakëve të pusetave,


rrugët e pashtruara dhe me pluhur apo ndotja e ajrit nga pluhuri e gazrat; prerja e pemëve dhe prishja e zonave të rekreacionit në qytet, etj.

Më poshtë janë paraqitur shqetësimet e publikut mbi problematikat mjedisore (shih Tab.4, grafiku 2). Djegia e kazanëve të plehrave (87.8%) dhe ndotja e ajrit (84.4%) identifikohen si problematikat mjedisore kryesore të publikut.

Tabela 4 - Shqetësimet e publikut mbi problematikat mjedisore

Shqetësimet e publikut mbi problematikat mjedisore		
Ndotja akustike	49	54,4%
Ndotja e ajrit	76	84,4%
Ndotja e ujit	32	35,6%
Ndotja e tokës	10	11,1%
Derdhja e mbetjeve interte	57	63,3%
Djegia e kazanëve të plehrave	79	87,8%
Prerja apo djegia e pyjeve a drurëve frutorë e dekorativë	17	18,9%

Grafiku 2 - Shqetësimet e publikut mbi problematikat mjedisore




Niveli i ulët i informimit dhe ndërgjegjësimit ndaj probleme mjedisore është një ndër konstatimet që identifikohet në pjesën më të madhe të tëintervistuarve. Ai reflektohet veçanërisht edhe përsa i përket autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e veprave penale mjedisore. Pjesa më e madhe e komunitetit beson se Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (86.7%) dhe Bashkia (80%) janë autoritetet kryesore përgjegjëse në parandalimin e veprave penale mjedisore (shih Tabela 5, Grafiku 3). Vetëm 35.6% besojnë tek policia si një autoritet parandalues i veprave penale

mjedisore. Mungesa e informimit dhe ndërgjegjësimit ndikon edhe reagimin e komunitetit ndaj këtyre problemeve dhe bashkëpunimin e komunitetit me policinë dhe autoritete të tjera përgjegjëse për parandalimin e veprave penale mjedisore.

Tabela 5 – Autoriteti përgjegjës për parandalimin e zbulimin e veprave penale mjedisore

Autoriteti përgjegjës për parandalimin e zbulimin e veprave penale mjedisore		
Policia	32	35,6%
Ushtria	0	0,0%
Bashkia	72	80,0%
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave	78	86,7%
Agjencia Rajonale e Mjedisit	26	28,9%
Qeveria	9	10,0%
Komuniteti	43	47,8%
Drejtori i shkollës	0	0,0%
Kryeplaku i lagjes	13	14,4%

Grafiku 3 – Autoriteti përgjegjës për parandalimin e zbulimin e veprave penale mjedisore




Përsa i përket denoncimit të veprave penale mjedisore vetëm 15.6% kanë bërë denoncime të këtyre veprave penale ndërsa 84,4% nuk kanë denoncuar asnjëherë (shih Tabela 6, Grafiku 4). Kjo theksohet fuqishëm edhe në takimet komunitare ku pjesa më e madhe e prindërve mohonin denoncimin, jo vetëm se nuk kishin informacion se

mund t'i drejtoheshin policisë së shtetit, por edhe për shkak të besimit të ulët ndaj institucioneve.

Tabela 6 – A keni parë apo denoncuar ndonjë krim mjedisor të kryer në komunitetin tuaj?

A keni parë apo denoncuar ndonjë krim mjedisor të kryer në komunitetin tuaj?		
Po	14	15,6%
Jo	76	84,4%

Grafiku 4 – A keni parë apo denoncuar ndonjë krim mjedisor të kryer në komunitetin tuaj?



Pjesa më e madhe e komunitetit do t'i drejtohej Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave dhe Bashkisë për të denoncuar një krim mjedisor. Policia e Shtetit njihet pak si një institucion adresimi për krimin mjedisor. Prezenca e punonjësve të policisë në takimet komunitare dhe plotësimin e pyetësorit nga të rinjtë përbënte një ndërgjegjësim të komunitetit për rritjen e bashkëpunimin me policinë e shtetit për veprat penale mjedisore.

VI. Konkluzione dhe Rekomandime

Mbrojtja e mjedisit është një nga sfidat më të mëdha të njerëzimit për të garantuar jetën, shëndetin, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social jo vetëm në afat shkurtër por edhe për brezat e ardhshëm. Në këtë mënyrë mbrojtja e mjedisit është një nga detyrat kryesore të të gjithë shoqërisë, çdo qytetari dhe pa dyshim qeverisë dhe institucioneve.

Përveç ndërgjegjësimit e edukimit, për mbrojtjen e mjedisit, është përcaktuar edhe një kuadër i gjerëkushtetues e ligjor i cili ka përcaktuar qëllimet e objektivat, të drejtat e detyrat, si dhe institucionet e kompetencat e tyre.

Si një mjet i fundit është parashikuar edhe dënimi penal për disa sjellje që janë veçanërisht të dëmshme për mjedisin që na rrethon si ndotja e ajrit; që është edhe shqetësimi kryesor i qytetarëve; ndotja e ujit, prerja e pyjeve, peshkimi i paligjshëm, prishja e qetësisë publike etj. Megjithatë numri i të dënuarve për këto vepra penale vazhdon të mbetet tepër i ulët krahasuar me perceptimin publik për përhapjen e këtyre veprave.

Mbrojtja penale e mjedisit nuk shihet si mjeti kryesor për mbrojtjen e tij nga qytetarët të cilët mendojnë më së shumti se mbrojtja e mjedisit është një kompetencë e organeve administrative dhe e pushtetit vendor. Vetëm një pjesë e vogël e tyre pranojnë se kanë parë një krim mjedisor apo të kenë kryer një denoncim në polici për një kundravajtje mjedisore.

Duke parë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, për të ndryshuar situatën është e domosdoshme që policia të nxisë bashkëpunimin me komunitetin me anë të strategjive të veçanta për policimin në komunitet dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo formë bashkëpunimi do të sillte një rritje të numrit të denoncimeve si dhe sigurimin e provave të nevojshme për dënimin e shkelësve të ligjit.

Gjithashtu është e nevojshme që të kryhen edhe reforma të kuadrit ligjor e kushtetues për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë të mjedisit.

Kështu Kushtetuta e Shqipërisë në Nenin 59 të saj, njeh si një objektiv social të drejtën për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm. Për të siguruar një mbrojtje kushtetuese të mjedisit është e nevojshme që e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe e drejta e informimit për mjedisin të njihet si një e drejtë kushtetuese e jo thjesht si një objektiv social. Kuadri ligjor do të përcaktojë në detaj se si kjo e drejtë do të garantohet në praktikë duke i njohur të drejtën çdo individit që ti drejtohet gjykatës për të kërkuar ndalimin e cenimit e dëmtimit të mjedisit si dhe shpërblimin e dëmit të pësuar.

Gjithashtu duhet të qartësohen kufijtë midis mbrojtjes administrative dhe asaj penale të mjedisit. Kuadri aktual ligjor dhe praktika e gjykatave kanë treguar që shpesh në praktikë është vështirë të bëhet ky dallim duke lejuar shmangien nga përgjegjësia penale.

Kodi penal me gjithë parashikimin e një sërë veprash penale ka nevojë për përmirësime duke parashikuar një rritje të dënimeve penale si dhe një numër më të madh veprash penale në përputhje me standardet e Bashkimit European në këtë fushë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit është e domosdoshme që e gjithë shoqëria të angazhohet për mbrojtjen e tij. Nuk mjafton vetëm edukimi, nuk mjafton vetëm ndërgjegjësimi, nuk mjafton vetëm veprimtaria e institucioneve apo e policisë. Vetëm nëse të gjithë këto elemente veprojnë në sinergji e në bashkëpunim me njëri – tjetrin do të garantohet një mjedis i shëndetshëm për të gjithë.